



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:290464

Datë: 29.10.2020

Numri i dokumentit: 01231151

P.nr.1389/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtare ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurve K.T. dhe T.M. ,për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve,substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1067-12/19, të datës 13.12.2019, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur më datë 26.10.2020, në prani të Prokurorit të Shtetit Ardian Emmini dhe të pandehurve K.T. dhe T.M., mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 29.10.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

I pandehuri K.T., nga i ati, e ëma, e gjinisë i lindur me dt., në fshatin, me vendbanim në Ferizaj rruga “.....” nr. .., me numër personal të lejes së njoftimit, ka të kryer fakultetin ekonomik, me profesion punëtor, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale.

I pandehuri T.M., nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur me dt.në, me vendbanim në Ferizaj rruga “.....” nr., me numër personal të lejes së njoftimit, ka të kryer fakultetin ekonomik, i pa martuar, me profesion punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale.

J A N Ë F A J T O R

Sepse

Më datë 27.05.2019, rreth orës 23:40, në rrugën e tranzitit në Shtime, gjatë një kontrolli që i kanë bërë policia veturës së tyre me të cilën kanë qenë duke udhëtuar, tek te njëjtit kanë gjetur një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë në peshë 0.46 gram, të cilën e kanë poseduar pa autorizim, për çka dhe e njëjta i është konfiskuar përkohësisht nga policia.

Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,21,38,39,40,43,41,43, 69, 70 dhe 269 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neni 365, 370 dhe 453 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurit i :

G J Y K O N

Të pandehurin K.T.

Me dënim me gjobë, në shumë prej 200 € /dyqind Euro/, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Të pandehurin T.M.

Me dënim me gjobë, në shumë prej 200 € /dyqind Euro/, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së, u konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike me peshë prej 0.46 gram, e cila ju është gjetur të pandehurve gjatë kontrollës nga policia.

Obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidare shumë prej nga 30 € /tridhjetë euro/, në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Poashtu obligohen të pandehurit që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajnë secili veç e veç shumë prej nga 30 € /tridhjetë euro/, në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1067-12/19, e dt.13.12.2019, ka ngarkuar të pandehurit për veprën penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31, të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të pandehurit të shpallen fajtor dhe tu shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitura për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të pandehurit gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 26.10.2020, në të cilën shqyrtim fillestar : që të dy të pandehurit u deklaruan fajtor për veprën

penale për të cilën i ngarkon aktakuza, për të gjitha pikat e saj, ndër të tjera i pandehuri K.T. ka shtuar se: ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, është hera e parë që jam takuar me substancë narkotike dhe e di që kam bërë gabim që e kam blerë dhe po premtoj se në të ardhmen më kësi lloj gabimi asnjëherë nuk do të përsëris, pasi që e kam kuptuar se përdorimi i narkotikëve është i dëmshëm. Ndërsa i pandehuri T.M. ka theksuar se: ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, është hera e parë që jam takuar me substancë narkotike dhe e di që kam bërë gabim dhe po premtoj se në të ardhmen më kësi lloj gabimi asnjëherë nuk do të përsëris, pasi që e kam kuptuar se përdorimi i narkotikëve është shumë i dëmshëm .

Gjykata lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohen, në bazë të nenit 248, paragrafi 2 të KPPRK-së, mori mendimin e prokurorit të shtetit, i cili deklaroi: se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPRK-së , në mbështetje të provave dhe fakteve që i përmban aktakuza , andaj i propozoj gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë së të pandehurve dhe të njëjtit ti shpall fajtor dhe tu shqiptoj një sanksion të paraparë me ligj, po ashtu në kuptim të nenit 269 par. 3 të KPRK-së , i propozoj gjykatës që të bëj konfiskimin e substancës narkotike të llojit marihuan me peshë prej 0.46 gram, e cila i është sekuestruar të pandehurve.

Pasi që të pandehurit kanë pranuar fajësinë, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë së tyre, shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248, par. 1, të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoj se të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimin e kanë bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe provat materiale të çështjes penale konkrete dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit siç janë: deklaratat e të pandehurve të dhëna në stacion të policisë me dt. 28.05.2019, vërtetimi i mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve i dt.28.05.2019, Raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, i dt. 26.11.2019, raporti i oficerit i dt. 09.12.2019, fotografit dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 248, paragrafi 4, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. (nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë

dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të gjithë të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin janë përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, për çka dhe të pandehurit u shpallën fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se që të dy pandehurit e kanë bërë pranimin e fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe të thellë dhe keqardhjen për veprën penale të kryer, se është hera e parë që kanë ra ndesh me ligjin si dhe premtimet e tyre se në të ardhmen nuk do të përsërisin kesi lloj vepre penale. Gjykata në rastin konkret për asnjërin nga të pandehurit nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se që të dy të pandehurit kanë bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethana të kryerjes, rrezikshmërisë së saj dhe autorëve të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ti përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale) .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par.2, pika 2.1 dhe 2.6. lidhur me nenin 453 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, gjykata i obligoi të pandehurit që për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajnë secili veç e veç shumën prej nga 30 € /tridhjetë euro/ në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**

P.nr. 1389/19, e datës 29.10.2020

Zyrtare Ligjore

Gjyqtari i vetëm gjykues

Kimete Bytyqi

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe Gjykatën.